



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0131**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Agon Ramadani - Kryetar, Vedat Poterqoi - Anëtar, Vjosa Gradinaj-Mexhuani - Anëtare duke vendosur sipas ankesës së OE N.N. 100 % Design Sh.p.k., kundër Vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Lagja e Hajdineve në Terizaj - Gjilan” me numër të prokurimit 207-22-10084-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, më 07/07/2023, morri këtë:

### **Vendim**

1. Aprovohet pjesërisht e bazuar ankesa e OE ankues lidhur me aktivitetin e prokurimit “Lagja e Hajdineve në Terizaj - Gjilan”, me numër të prokurimit 207-22-10084-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e AK-së.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.
3. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 22.02.2023, Ministria e Kultures Rs dhe Çjk, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 njoftimin për dhënie të Kontratës, aktivitetin e prokurimit “Lagja e Hajdineve në Ferizaj - Gjilan”, me numër të prokurimit 207-22-10084-5-2-1, ku është rekomanduar për

kontratë “Limiti Proccject” sh.p.k- Gllogovc.

Me datë 27.02.2023, Operatori Ekonomik “N.N. 100 % Design Sh.p.k., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Ministria e Kulturës Rs dhe Çjk, me datë 02.03.2023, AK Ministria e Kulturës Rs dhe Çjk, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 22.02.2023.

Me datën 11.03.2023, Operatori Ekonomik “N.N. 100 % Design Sh.p.k., ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 131/2023, kundër njoftimit mbi vendimin e AK për dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura të hapur, lloji i kontratës: Shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 415,000,00 € vlerë e madhe.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 25 janar 2023 me raportin e ekspertizës. AK Ministria e Kulturës Rs dhe Çjk, ka deklaruar se pajtohem me mendimin e ekspertit shqyrtues. Me datë 03.04.2023 OE “N.N. 100 % Design Sh.p.k., ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 22.03.2023, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE “N.N. 100 % Design Sh.p.k., të aprovohet si e bazuar.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 22.02.2023, nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

*-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues*

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij nuk janë të pranueshme në të gjitha pikat për faktin se i njëjti nuk ka ofruar hulumtime dhe të gjetura që janë në harmoni me gjendjen faktike si dhe legjislacionin në fuqi lidhur me çështjet që do të shtjellohen si më poshtë dhe si rrjedhojë paneli vendosi që të mbetet në fuqi njoftimi për kontratë ndërsa poashtu lidhur me çështje konkrete AK të vërtetojë faktet dhe pajtueshmërinë e dokumentacionit të ofruar nga ana e OE të rekomanduar në raport me pretendimet e ngritura subjekt i kësaj ankese.

Lidhur me pretendimet ankimore si objekt shqyrtimi i kësaj ankese, paneli shqyrtues konstaton se si çështje kyçe përcaktuese që sollën deri tek vendim-marrja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi ishin çështjet e ngritura nga OE ankues që parimisht konsistojnë në kundërshtimin e anulimit të tij si dhe pretendimet e ngritura kundër OE të rekomanduar për kontratë, andaj çështjet përcaktuese do të trajtohen nga ana e panelit shqyrtues ndërsa pretendimet tjera paneli ka konstatuar se nuk qëndron nevoja e trajtimit të tyre në detaje për faktin se sikurse edhe ato të ishin të bazuara të njëjtat nuk do të ndikonin në rezultatin përfundimtar të vendim-marrjes të këtij vendimi.

Lidhur me pretendimet ankimore kundër anulimit të tij nga ky aktivitet prokurimi, PSH konstaton se çështjet kryesore përcaktuese që pas analizimit të tyre kanë rezultuar që OE ankues nuk përmbush kriteret obligative të kërkuara e poashtu veprimet e ndërmarra që bien ndesh me LPP, lidhur me të njëjtin, PSH ka arritur në përfundim se eliminimi i tij nga ana e AK-së është i qëndrueshëm për arsyet e dhëna si më poshtë, ndërsa pretendimet tjera ankimore kundërt eliminimit të tij nuk do të trajtohen nga ana e PSH përkundër faktit që edhe pse janë evidentuar lëshime si dhe arsyetime të paqëndrueshme lidhur me eliminimin e OE të rekomanduar nga ana e AK-së, kjo përsëri nuk do të nënkuptonte rezultat tjetër përfundimtar.

Lidhur me arsyen e eliminimit për mos plotësimin e kriterit numër 4, me të cilin kërkohet që OE të paraqesin listën prej së paku 10 punëtorë mbështetës, me ç ‘rast pas kërkesës për informacione shtesë OE ankues ka dorëzuar plotësimin e dokumentacionit me të cilin është plotësuar stafi me dy teknikë tjerë që nuk kanë qenë pjesë e listës së punëtorëve në ofertë, PSH konstaton se konform nenit 59 të LPP-së ky plotësim klasifikohet si ndryshim material i ofertës, andaj arsyetimi i AK-së mbi këtë pikë është i qëndrueshëm.

Lidhur me arsyetimin për kërkesën mbi pajisjet, përveq faktit që në pajisjet e paraqitura nga OE ankues pesë pajisjet e cekura nga AK për të cilat nuk janë dorëzuar vërtetimet e pagesave të tyre, poashtu PSH morri në konsideratë faktin se OE ankues pas kërkesës për sqarime lidhur me kërkesën nr 7, Gypa për largimin e interneve në punishte, në përgjigje të kërkesës për sqarime, OE ankues ka ofruar një faturë nga një fuernizues tjetër, e jo nga furnizuesi i paraqitur në ofertë, andaj poashtu ky veprim nga ana e PSH klasifikohet se bie ndesh me nenin 59, i cili saktëson se informacioni i dorëzuar nuk mund të përmbajë ndryshim material të ofertës.

Lidhur me pretendimet ankimore të ngritura kundërt OE të rekomanduar për kontratë,

OE ankues ka ngritur pretendime lidhur me plotësimin e kërkesës për raportin e vlerësimit të riskut, për të cilën në DT është kërkuar që e njëjta kërkohej nga lideri i konzorciumit, andaj PSH konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar për faktin se raporti i paraqitur nga anëtari i konzorciumit me të drejtë nuk është pranuar nga ana e AK-së.

Lidhur me pretendimin sa i përket raportit të vlerësimit të riskut, OE i rekomanduar në ofertën e tij ka paraqitur dokumentacionin me nr rendor 9. Në të cilin janë evidentuar:

1. DOKUMENTI I VLERSIMIT TË RISKUT – NOTERIZUAR

2. Deklaratë mbi përfundimin e aktit të vlerësimit të riskut – NOTERIZUAR

3. Vërtetim mbi vlerësimin e aktit të vlerësimit të riskut

– NOTERIZIMI DEKLARAT MBI PERFUNDIMIN E RRISKUT NOTERIZUME 06.09.2022

- LICENSA – VENDIM

Bazuar në përmbajtjen e këtyre dokumenteve, PSH nuk mund të konstatojë në mënyrë meritore se kriteri i lartpërmendur përmbushet plotësisht duke qenë se afatet e skadimit si dhe çështja e përfundimit të procesit të vlerësimit si dhe të rivlerësimit të riskut nuk janë të qarta, andaj mbetet në përgjegjësi të plotë të AK-së, që përgjatë procedurave të ardhshme të vërtetojë në se kriteri relevant është përmbushur nga ana e OE të rekomanduar duke u bazuar në dokumentacionin e paraqitur në ofertë.

Lidhur me çështjen e licencës së paraqitur nga Mineral LCC, PSH ka arritur në konstatimin se AK ka vepruar konform nenit 59 si dhe ofrimi i sqarimeve shtesë, licencës tjetër me afat si dokument është i pranueshëm për faktin se dokumenti i ofruar me sqarime përmban kompaninë e licencuar të njëjtë me numër të biznesit të njëjtë me dokumentin paraprak, si dhe poashtu në ofertën e tij ka paraqitur marrëveshjen e noterizuar, poashtu data e lëshimit të dokumentit është evidentuar se është para hapjes së ofertave, andaj në këtë rast konstatohet se ky veprim i ndërrmarrë nuk përbën shkelje të nenit 59, gjithashtu PSH lidhur me këtë pretendim nuk ka gjetur mbështetje tek raporti i ekspertizës sepse lidhur me këtë licence i njëjti i ju është referuar kërkesës tjetër, lidhur me vlerësimin e riskut, ndërsa kjo kërkesë ka të bëjë me furnizim me zhavor.

Andaj përfundimisht, mbetet në përgjegjësinë e plotë të AK-së që, ekzaminimi, vlerësimi dhe rekomandimi i ofertës të jetë në harmoni të plotë me LPP-në.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Agon Ramadani**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- **OE - N.N. 100 % Design Sh.p.k.**
- Arkivës së OSHP-së: